



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Kuvendi i Komunës Klinë
Komiteti për Politikë dhe Financa
01Nr 06-61394 /23
Klinë, dt: 11.11. /23

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e XI e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më 10.11.2023, me fillim nga ora 9:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi, z. Fadil Gashi, i cili përshëndeti Policinë e Kosovës, anëtarët e Komitetit, drejtorët dhe të pranishmit të cilët ishin pjesëmarrës në mbledhje të KPF-së.

Më pas, Kryesuesi prezantoi rendin e ditës:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i draft-strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për komunën e Klinës 2023-2028,
4. Shqyrtimi i draft-planit të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2023-2026,
5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shtator-tetor 2023,
6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Përshëndetje, mirë se keni ardhur në mbledhje të Komitetit për Politikë dhe Financa, e përshëndes edhe Policinë e Kosovës që i kemi këtu bashkë me ne, drejtorë të drejtoreve, zyrtarë tjerë!

Rendin e ditës besoj e keni marr bashkë me materialin në vazhdimësi, unë po hap debat rreth rendit të ditës. A ka dikush, kush është për?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua rendi i ditës.

Pika 1. Arsyetimi i mungesave.

Fadil Gashi, kryesues: Jemi të gjithë prezantë.

Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush rrëth procesverbalit? Atëherë, kush është për?

Me 7 vota PËR, asnjë kundër dhe asnjë abstenim u miratua procesverbali i mbledhjes së kaluar.

Pika 3. Shqyrtimi i draft-strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për komunën e Klinës 2023-2028.

Fadil Gashi, kryesues: Unë po ju informoj që javën e ardhshme e kemi edhe debatin e fundit të konsultimit publik për këtë dokument. Ne, me një takim që e kemi pasur edhe me përfaqësues, edhe me drejtorë të drejtoreve, edhe me kryetarin, i kemi nxjerr disa çështje që unë i kam identifikuar përvete. Po besoj e merrni edhe ju materialin edhe si KPF është mirë me qenë edhe në debat kur ta organizojmë javën që vjen edhe me parë a keni vërejte, a ka ndonjë plotësim, megjithëse nuk ka shumë për plotësim, sa ka përfunduar, sepse gati gjysma e materialit është histori, e kemi fjalën qysh me zhvilluar Klinën, jo veç lëndë të historisë. Ne m'i sanuar deri të shkojmë në seancë të kuvendit, me miratuar, krahas kësaj po besoj që e dini se është duke u hartuar po më duket në hapat e fundit, është mbajtur edhe një takim për planin zhvillimor komunal, që ajo është e rëndësishëm së veçantë, po edhe kjo nuk është që se ka rëndësinë e vet si strategji. Unë po ju lus edhe njëherë miqësisht, është mirë me qenë kushdo që keni mundësi, si KPF edhe kur ta organizojmë debatin edhe me publikun, nuk është dokument i parëndësishëm, por konsultohuni edhe nga secila nga pak, mund ta pasurojmë, ka bukur shumë. A ka dikush rrëth kësaj? Po, Tunë?

Tunë Deda: Pëershëndetje, kryesues, për ju, pëershëndetje për Policinë e Kosovës, drejtorët dhe gjithë të pranishmit që janë këtu! Është shumë mirë, por është mendim i imi personal, që në këtë plan të parashihet hapja e kanalizimeve dhe pendët përujitje, cdo pëllëmbë tokë që është e mundshme për t'u ujitur është mirë të parashihet në këtë plan zhvillimor që vetëm ashtu i ndihmojmë bujqit e komunës së Klinës. Toka sidomos përmisë, që nuk ujitet, nuk ka asnjë rendiment e shpesh ata thonë që kemi investuar, kemi bërë, që ka kanalizime. Unë jam shumë i bindur se as 50% të sipërfaqeve të mundshme përujtime nuk ja kemi ofruar qytetarëve, kaq!

Fadil Gashi, kryesues: I ka, kjo strategji i ka. Plani zhvillimor është një dokument tjetër që

është duke u hartuar, kjo është strategjia, dmth i kemi dy dokumente të ndryshme po edhe këtu janë të planifikura. Unë e thash, disa gjëra që janë bukur të mëdha, gjysma e këtij materiali nuk ka nevojë me qenë se është histori. Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Unë, kryesues, nuk e di sa isha i qartë, por unë propozova këtë draft të zhvillimit që është ekonomik lokal 2023-2028, të parashihet në draft që asnjë pëllëmbë tokë që është e mundshme mos të mbetet pa u përfshirë këtu edhe me u kryer, me u punuar, se unë e di edhe kur kemi qenë para 8 viteve në Durrës që e kemi bërë planin edhe atëherë ka qenë e paraparë, edhe atëherë ish-drejtori i Bujqësisë thoshte e kemi kryer 80% të kanaleve të mundshme për ujitje, 80% s'janë as sot të kryera, kur të dëshironi mund të dalim në terren edhe me parë sa ka kanalizime për ujitje të kryera në komunën e Klinës. Do të thotë duke e përfshirë prej Stupe e deri atje në Pjetërq të Epërm dhe Dollovë nuk ka, do të thotë ka mundësi shuma të mëdha me investuar që mos të mbetet asnjë pëllëmbë tokë pa u ujitur, sepse unë jam bujk vet dhe merrem me bujqësi, edhe e di që ajo tokë në rrafsh që nuk ujitet edhe do të mbetet është 10% që e nxjerr, nëse e ujit 100% e nxjerr ose më ndryshe, 10.000 kg misër i gjen nëse e ujit tokën, në hektarë, nëse nuk e ujit e gjen 1000 ose 2000.

Fadil Gashi, kryesues: Po, urdhëro, drejtor?

Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Përshëndetje për të gjithë, dua veç një informatë ta jap: 6 000 metra janë bërë në komunën e Klinës kanale të ujitjes edhe tash e kemi miratuar buxhetin, kryesuesi e tha mirë, veç me e rritë buxhetin, s'ka nevojë tjetër gjë të bëhet. Buxheti i Bujqësisë këtë vit është aprovar, po kemi edhe subvencione prej zyrës së kryetarit, kështu që, mund edhe t'i risim edhe besoj se 80% është kaluar.

Fadil Gashi, kryesues: Po, Tunë ?

Tunë Deda: Unë kur flas diçka, drejtor, kurrë nuk flas përmendësh! E di se i keni sjellë 6 000 metra, po nevojat janë shumë më të mëdha, tash dua t'i tregojë me foto ku nuk e keni bërë asnjë vijë: Zajmi, nuk është vënë asnjë metër, ka qenë një pendë e ndërtuar, por është prishur brenda viti; në Deiq nuk është asnjë metër kanalizim; Videjë nuk është asnjë metër kanalizim edhe në asnjë vend nuk e keni përfunduar një fshat, me thonë e keni përfunduar krejt edhe lulëzon ai fshat. Unë nuk po them që je fajtor ti, por në përgjithësi unë angazhohem që mos me mbetë tokë e mundshme ku e rrok ujitja edhe m'u ujitur, ky është angazhimi im edhe sa i përket ndarjes së mjeteve në bujqësi, kryesuesi e di mirë se unë jam angazhuar edhe pa u bërë buxheti, me ndarë më shumë mjete, edhe jam ihtar me u ndarë më shumë mjete për bujqësi, sepse ti jua mundëson fshatarëve të rrinë në fshat, ta punojnë tokën edhe t'i kenë përfitimet e veta.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft-strategjisë për zhvillim ekonomik lokal për Komunën e Klinës 2023-2028, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekomandoi që draft-strategjia të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Pika 4. Shqyrtimi i draft-planit të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2023-2026.

Fadil Gashi, kryesues: Edhe me këtë i kemi konsumuar gjitha procedurat duke e përfshirë edhe konsultimin me publikun, se njëherë na ka dështuar për shkak të mungesës së pjesëmarrjes. Vet i propozojnë e vet nuk vijnë, bile qaty me qenë fizikisht, por e ka rëndësinë e veçantë edhe e kam kërkesë eksplikite prej ministrisë së brendshme se ka të bëjë me ri-adresimin e qytetarëve të komunës së Klinës. Për shkak të rëndësisë, ne si kuvend edhe si komitet i kemi kryer të gjitha procedurat, e kemi edhe konsultimin e fundit publik, e kemi edhe dokumentin edhe planin e realizimit duke i përfshirë edhe kostot financiare. A ka dikush, kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të draft- planit të veprimit për të zhvendosurit dhe zgjidhje të qëndrueshme 2023-2026, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim, rekandoi që të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Pika 5. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin shtator-tetor 2023.

Fadil Gashi, kryesues: I kemi 4 kërkesa që na vijnë nga Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim:

Kërkesa 1.

Propozim-vendimi për shtim të buxhetit për krijimin e kodit të ri për “Furnizim me shkrirëse dylli” në shumën prej 2,745.00 (dymijë e shtatëqind e katër dhjetë e pesë euro)€ - kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere. Komuna financon me mjete në shumë prej 6,405.00 € kurse qytetarët me 2,745.00 €, vlera e tërësishme e projektit eshë 9,150.00 €.

Kërkesa 2.

Propozim-vendimi për shtim të buxhetit për krijimin e kodit të ri për “Furnizim me mekanizëm bujqësor - Mbjellëse për grurë” në shumën prej 3,657.00 (tremijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e shtatë euro)€ - kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere. Komuna financon me mjete në shumë prej 8,533.00 € kurse qytetarët me 3,657.00 €, vlera e tërësishme e projektit eshë 12,190.00 €.

Kërkesa 3.

Propozim-vendimi për shtim të buxhetit për krijimin e kodit të ri për “Furnizim me mekanizëm

bujqësor - Mbjellëse për misër” në shumën prej: 3,595.50 (tremijë e pesëqind nëntëdhjetë e pesë euro e pesëdhjetë cent) € - kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere. Komuna financon me mjete në shumën prej 8,533.00 € kurse qytetarët me 3,657.00 €, vlera e tërësishme e projektit eshë 12,190.00 €.

Kërkesa 4.

Propozim-vendimi për shtim të buxhetit për krijimin e kodit të ri për “Furnizim me mekanizëm bujqësor - Freza” në shumën prej 4,734.00 (katërmijë e shtatëqind e tridhjetë e katër euro)€ - kategoria ekonomike Subvencione dhe Transfere. Komuna financon me mjete në shumë prej 11,046.00 € kurse qytetarët me 4,734.00 €, vlera e tërësishme e projektit eshë 15,780.00 €.

Fadil Gashi, kryesues: Drejtorët i kemi këtu nëse na nevojitet ndonjë sqarim shtesë, urdhëro, drejtor?

Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Po, kryesues, faleminderit! Kodi i bashkëfinancimit kërkohet të aprovohet dmth për kuvend këtu edhe dërgohet në ministri, kështu që, kjo është arsyja. Ne nuk kemi mundur, se ka qenë edhe një kërkesë më herët se pse më herët nuk e kemi bërë, por se kemi ditur shumën, dmth pa e marr përfituesi, kush është përfitues dhe ne me ditë saktë shumën, kjo është arsyja. Atë e kemi bërë para një jave dhe ndoshta gati për pak jemi vonuar me ardhur këtu në komitet, po kryesorja është e bërë dhe në kuvend do të aprovohet sepse pa shkuan në ministri kjo nuk mund... ai operatori t'i merr edhe 30% të bashkëfinancimit prej fermerëve, kodi ynë është, por duhen 2 kode kur është bashkë me bashkëfinancim.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, unë edhe njëherë po i përsëris prej të parës deri te e katërtë: Kërkesa e parë është përfrezat, shuma 4 734 00 euro; kërkesa e dytë ka të bëjë me furnizim me shkrirëse dylli për bletarët, vlera është 2 745,00 euro; kërkesa e tretë është mbjellëse për misër, shuma 3 595 00 euro dhe e fundit; mbjellëse për grurë, shuma 3 657 00 euro. A ka dikush? Po, urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Po, kryesues, ne pajtohami edhe është shumë mirë që Drejtoria e Bujqësisë ju del në ndihmë të qytetarëve dhe pajtohami që kjo shumë të ndahet.

Fadil Gashi, kryesues: Po, drejtor?

Lorenc Marleku, drejtor i Bujqësisë: Nuk ndahet kjo shumë, kjo është bashkëfinancimi me qytetarë, dmth ne vetëm kemi me aprovuar këtë kodin e bashkëfinancimit.

Fadil Gashi, kryesues: A ka dikush, a dëshironi një nga një apo t'i votojmë të katërtat përnjëherë? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, pas shqyrtimit të propozim-vendimeve të Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim, me 7 vota PËR, pa ndonjë vërejtje apo sugjerim,

rekomandoi që të gjitha propozim-vendimet për shtim të buxhetit dhe krijimin e kodit të ri për participim, të kalojnë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Kërkesa 5.

Kërkesë e parashtruar nga Kolë Pashk Milicaj nga fshati Jagodë i Komunës së Klinës, i cili është pronar i njësisë kadastrale Nr.00099-3 Z.K. Jagodë me sipërfaqe prej 5441m² bazuar në Ligjin 06/L-092 kërkon këmbimin e pronës me parcelën Nr. 00165-7 Z.K. Jagodë në sipërfaqe prej 3601 m² e cila është në emër të Komunës së Klinës.

Kërkesa 6.

Kërkesë për ndërrimin e pronave nga Pjetër Tomë Milici nga fshati Zllakuqan, komuna e Klinës, të cilin e përsaqëson me autorizim avokati Hil Prenaj nga Klina.

Parashtruesi i kërkesës thekson se: Vazhdimi i kërkuar para 6 vitesh në procedurë administrative që të bëhet ndërrimi i pronave për shkak se në parcelën time nr. 00696-1 Z.K. Berkovë, me sipërfaqe prej 3336m² ka dalë që është e ndërtuar në një pjesë të kësaj parcele zyra e vendit në Zllakuqan.

Ndërsa në pronën e Komunës së Klinës e regjistruar si njësi kadastrale me nr.000698-O Z.K. Berkovë me sipërfaqe prej 1024m² ka dalë i ndërtuar objekti im në këtë parcelë.

Me anë të kësaj kërkesë në bazë të Ligjit nr. 06/L-092 dhe Rregullores QRK nr.09/2020 si pronar faktik dhe juridik i njësisë kadastrale nr. 00696-1 Z.K. Berkovë, me sipërfaqe prej 3336m², pjesa e kësaj prone me sipërfaqe prej 746m², kërkoj të kalojë në pronësi të Komunës së Klinës në emër të ndërrimit dhe nga pjesa e njësisë kadastrale nr.0000698-0 Z.K. Berkovë, sipërfaqja prej 746 m² që është në emër të Komunës së Klinës të kalojë në emër të Pjetër Milici.

Fadil Gashi, kryesues: Është fjala për dy këmbime që kërkon të bëhen se janë parcela të ndryshme, procedurën e dini si bëhet këmbimi i pronave dhe ju nëse pajtoheni, ne këtë kërkesë me ja përcjell Drejtorisë së Urbanizmit dhe Zyrës së kryetarit, ata me u konsultuar me gjithë procedurat e nevojshme sipas kërkesës së Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronave Publike dhe nëse është gjithçka në rregull ata na kthejnë poshtë kërkesën e tyre me dosje komplet dhe ne e procedojmë. Nëse ju kujtohet në fillim të këtij viti i kemi proceduar 4 prona për këmbim, ne pa i ditur këto procedura me dal atëherë në vend të ngjarjes, m' i konstatuar sipas ligjit, a janë fqinje pronat, janë disa kritere që duhet m' i plotësuar, po në fund kërkesën na bie kryetari i komunës, duke u bazuar në këtë dy kërkesa, a ka dikush? Urdhëro, Tunë?

Tunë Deda: Po, kryesues, është mirë gjithmonë të këqyret edhe në interes të qytetarëve nëse është edhe të atyre që e kanë bërë kërkesën po edhe në interes të komunës, nëse është e mundur me ju dal në ndihmë, por gjithmonë të parashihet ligji, krejt çka i mundëson zyra ligjore që thotë është në rregull është mirë me e bërë.

Fadil Gashi, kryesues: Ne e kemi marr një vendim në fillim të vitit nëse ju kujtohet edhe ende s'kemi mundur ta procedojmë më shumë, se ne kur ta marrim vendimin në kuvend, ne duhet ta dërgojmë në ministri, është njësia e veçantë që e bën vlerësimin e pronave edhe duhet me dal në terren dhe ata s'dalin kurrë, po nuk do me thënë që ne me mbetur peng, po rruga ligjore është

kështu, të shkojë në drejtori, le të shkojë te zyra e kryetarit, kryetari ne na bën kërkesën duke u bazuar në këto dy kërkesa, që janë të dyja për këmbim prone, njëra në Zllakuqan, tjetra në Jagodë. A ka dikush tjetër? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e parashtruar nga z. Kolë Pashk Milicaj dhe z. Pjetër Milici, për këmbime të pronës, të dërgohet për shqyrtim në Zyrën e kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06./L-092 dhe Rregullores (QRK) nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

Kërkesa 6.

Kërkesë e parashtruar nga Mustaf Gashi, përfaqësues i banorëve të lagjes “Balaj” në fshatin Sferkë, të cilët me anë të kësaj kërkesë kërkojnë që t'u ndahet një parcelë prej 5 ari nga parcela P-71010072-00558-0 Zona Kadastrale Sferkë, pronë e Komunës së Klinës e cila ju nevojitet për ndërtimin e një objekti i cili do të shërbente për nevojat e bashkëfshatarëve.

Fadil Gashi, kryesues: Në kërkesën e parë është bërë një defekt, tash e kemi edhe një plotësim të kërkesës, se ata kërkesën e parë e kanë shkruar fshati Sferkë, realisht nuk është fshati, por është një lagje. Ne kemi kërkuar që drejtoria, nëse ju kujtohet, si komitet me dal në vend të ngjarjes me bërë incizimin dhe sipas dokumenteve, kur bëhet ai incizim në vend të ngjarjes me parë a bien ndesh me dokumentet tona, edhe plani zhvillimor, edhe strategjisë, edhe hartave zonale. E tash ne e kemi pasur një precedent më herët, e kemi pasur një kërkesë të Zajmit, mirëpo prona ka qenë e shkollës ku e kanë kërkuar ata, se neve na është kthyer ajo prej ministrisë, se ajo prona ka qenë e shkollës. Kjo nuk ka pengesë në pronë dhe ky është dallimi, unë po ju them kam dëshirë me aprovuar, me kaluar ne edhe me ja dërguar ministrisë, e verifikojnë, nëse ka dikush, urdhëroni?

Tunë Deda: Po, kryesues, faleminderit shumë, unë së pari i përgëzoj ata qytetarë që e kanë marr një iniciativë të tillë dhe pajtohem që ajo parcelë të ju ndahet dhe të angazhohemi ta dërgojmë në ministri. Besoj që edhe Ministria e Pushtetit Lokal nuk ka me bërë pengesë sepse ajo është për të mirën e qytetarit.

Fadil Gashi, kryesues: Faleminderit, dikush tjetër? Kush është për?

Komiteti për Politikë dhe Financa, me 7 vota PËR, rekomandoi që kërkesa e banorëve të lagjes “Balaj” të kalojë për shqyrtim dhe miratim në kuvend.

Pika 6. Të ndryshme.

Fadil Gashi, kryesues: Të ndryshme, a ka dikush? Faleminderit të gjithëve për pjesëmarrje!

Procesmbajtësja,
Monika Palushi

Monika Palushi



KRYESUESI,
Fadil Gashi

Fadil Gashi